



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 16.04.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-3535/13, për z. Afrim Bajraktari – Menaxher i Prokurimit në Universitetin i Prishtinës “Hasan Prishtina”, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-3535/13, për zyrtarin e lartë për z. Afrim Bajraktari – Menaxher i Prokurimit në Universitetin i Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.Sh.P. “B & V”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Bajraktari, fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet, dhe me ndryshimet që duhet t'i bëj për të shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit. Në këtë takim ai ka konfirmuar se në cilësinë e zyrtarit të lartë ushtron funksionin e Menaxherit të Prokurimit në Universitetin i Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe po ashtu është pronar në biznesin privat N.Sh.P. “B & V”.

Zyrtari i lartë publik ka kuptuar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik dhe përveç ndryshimeve të kërkuara nga AKK, vullnetarisht ka vendosur që ta shuaj biznesin.

Ndërkohë, z. Bajraktari, ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 1278/14) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka mbyllur biznesin privat.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

